



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 1868 prot.

Shkodër, më 31.05. 2022

V E N D I M


Nr. 115, datë 31.05. 2022

"Për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të USH-së"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 38, pika 1, germa d; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa b, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2022

Vendosi:

1. Të miratojë Strategjinë e zhvillimit të USH-së, bashkëlidhur.
2. I kalohet Bordit të Administrimit për miratim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI” 2022-2026

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E

UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

2022-2026



STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

PARATHËNIE

Në emër të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, është kënaqësi që të ju prezantojmë Strategjinë e Zhvillimit të këtij Universiteti për periudhën 2022-2026.

Kjo strategji përcakton drejtimet kryesore për pesë vitt e ardhshme të Universitetit të Shkodrës. Përmes saj ne si Institucion i Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, kemi ripërcaktuar rrugët më efektive për të arritur vizionin tonë. Planii 2022-2026 synon ta pozicionojë Universitetin tonë si një nga universitetet më të mira në vend e rajon si dhe të vijojë atë në rrugën e ndërkombëtarizimit.

**REKTORI
PROF. DR. SIMEON GOLEMI**



STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Përbajtje	
PARATHËNIE	2
HYRJE	4
Qëllimet strategjike	6
Grupet e interesit	7
Kultura dhe vlerat e USH-së	7
Stafi i USH-së	8
Infrastruktura e USH-së	8
OBJEKTIVAT SPECIFIKE	10
Objektivi specifik 1: Rritja e cilësisë	11
Objektivi specifik 2: Përsosmëria në mësimdhënie dhe kërkim	14
Objektivi specifik 3: Ndërlidhja me tregun e punës	17
Objektivi specifik 4: Integriteti dhe transparencë	29
Objektivi specifik 5: Studentët	31
Objektivi specifik 6: Ndërkombëtarizimi i USH-së	33
Objektivi specifik 7: Shërbimet digitale	37



STRATEGIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJGJ GURAKUQI” 2022-2026

HYRJE

Për një universitet cilësor, për një universitet të hapur, për të ardhmen e studentëve tanë!

Me rrënjët e tij në një qytetërim të hershëm evropian, mbështetur në një traditë të shkëlqyer arsimore dhe edukative, me një staf shumë të kualifikuar e profesional, vendas dhe të huaj, me mundësi të shumta zgjedhjeje programesh studimi sipas fakulteteve të tij, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (USH) ofron mundësi të shkëlqyera për ndjekjen e studimeve të larta universitare.

Strategja e zhvillimit të USH-së 2022-2026 trajton të gjitha fushat prioritare të USH-së. Ajo është hartuar në përshtatje me objektivat kryesorë të zhvillimit të arsimit të lartë në vend, Evropë dhe botë. USH synon të përmirësojë performancën e tij dhe të radhitet mes institucioneve më cilësore të arsimit të lartë në vend e rajon. Kjo strategji është hartuar përmes bashkëpunimit dhe kontributit serioz mes stafit akademik të USH-së dhe atij administrativ. USH aspiron të:

- të plotësojë aspiratat e studentëve duke iu mundësuar arritjen e plotë të potencialit të tyre;
- të sigurojë një arsim cilësor dhe me vlera për të gjithë studentët duke iu siguruar atyre zhvillimin e kompetencave, etikës, vlerave qytetare të cilat do t'u shërbejnë në jetë dhe karrierrë;
- të zhvillojë partneritetet të qëndrueshme me IAL-të dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkimit dhe mësimdhënies;
- të kontribuojë në mënyrë efektive në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike në vend dhe në rajon;
- të ketë një staf akademik konkurrues në treg, duke i siguruar mundësi të barabarta rekrutimi, zhvillimi personal dhe avancimi në karrierrë;

Përmes kësaj strategjive USH do të mundë të monitorojë progresin e arritur hap pas hapi duke përdorur indikatorë të matshëm dhe të specifikuar në kohë. Kjo strategji zhvillimi përbën objektiva afatshkurra dhe afatgjata të cilat pritet të realizohen brenda vitit 2026, por, gjithashtu, ka edhe fleksibilitetin që, në varësi të ndryshimeve në mëdisin e jashtëm të Universitetit, të përshtatet dhe të zhvillohet. Pavarësisht se do të jetë një guidë e përgjithshme për objektivat dhe aktivitetet e periodit 2022 – 2026, kjo strategji përbën një vizion dhe aspirata më të gjera që shkojnë përtjerë kësaj periudhe dhe që do të shërbejnë për hartimin e planeve të tjera të mëvonshme strategjike të USH-së. Strategja e zhvillimit është hartuar përmes një analize strategjike të USH-së duke u fokusuar në pikat tilla, si:

- Evidencimin dhe analizimin e problemeve aktuale të USH-së;
- Evidencimin e rëndësise që ka planifikimi strategjik në këtë fazë zhvillimi.
- Analizën e zhvillimit të arsimit të lartë në Vendet e Evropës dhe më tej.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Vështrim i përgjithshëm

Më 2 shtator 1957 në Shqipëri u hap Instituti i Lartë Pedagogik i Shkodrës (ILP). Ai u konsiderua si një nga institucionet më të rëndësishme të vendit dhe qendra më e madhe mësimore, kërkimore-shkencore dhe kulturore e Veriut të Shqipërisë. ILP-Shkodër ka pasur filialat e veta në Elbasan, Gjirokastër, Korçë, Berat, Durrës, Fier, Vlorë dhe qendrat e konsultimit në Tiranë, Peshkopi dhe Sarandë. Ky institucion në vitin 1991 u ngrit në nivelin e Universitetit (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”). Deri në vitet 1990-të ky institucion ofronte degë studimi të larmishme, si: Gjuhë, Letërsi, Histori, Matematikë, Fizikë, Biologji, Cikli i Ulët etj. Pas viteve 1990-të, USH hapi Fakultete të reja, si: Fakultetin e Drejtësisë, Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Sot USH ka 6 fakultete: Fakultetin e Shkencave Shoqërore me 4 departamente dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike; Fakultetin e Shkencave të Edukimit me 4 departamente; Fakultetin e Shkencave të Natyrës me 5 departamente dhe Qendrën e Studimit të Ujëzave të Rajonit të Shkodrës; Fakultetin Ekonomik me 3 departamente; Fakultetin e Drejtësisë me 3 departamente; Fakultetin e Gjuhëve të Huaja me 3 departamente. Në rrugëtimin e tij 65 - vjeçar Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka diplomuar 39538 specialistë të cilët shërbejnë në fusha të ndryshme të dijes e të shkencës, si dhe në organe qendore drejtuese, duke dhënë këshfu një kontribut të vyer jo vetëm në arsimin tonë kombëtar, por edhe në sektorë e fusha më rëndësi jetike për kombin.

Vizioni

USH synon të jetë një nga institucionet arsimore të larta në Shqipëri me standardet më të larta bashkëkohore dhe të ofrojë programe studimi tradicionale dhe të reja në përputhje me kërkosat e tregut të punës, cilësi në mësimdhënie, risi në këkim shkencor, të rrisë partneritetin me komunitetin, organet vendore dhe qendore, institucionet e ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare. USH synon të kontribuojë në mënyrë efektive në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike në vend dhe në rajon.

Misioni

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është Institucion i Arsimit të Lartë publik dhe misioni i tij është të krijojë, të zhvillojë, të përzgjedhë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënieς dhe kërkimit shkencor. USH i ofron mundësi të gjithë studentëve që të përfitojnë një eksperiente shkuese me cilësi të lartë dhe të angazhohen në aktivitete kërkimore dhe krijuese, për të diplomuar student të aftë profesionalë, në mënyrë që të mund të japin kontribut me vlerë për komunitetin, vendin dhe më gjerë

STRATEGJA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJGJ GURAKUQI” 2022-2026

Qëllimet strategjike

Mbështetja e suksesit të përgjithshëm akademik të studentëve.

Zhvillimi i programeve të përbashkëta me universitetë të tjera rajonale dhe ndërkombëtare.

Aftësimi i mëtejshëm i studentëve për të qenë të suksesshëm në tregun e punës.

Rritja e transparencës e veprimitarisë së USH-së.

Përmirësim i kapaciteve akademike për kërkim shkencor.

Rritja e granteve dhe aktivitatave.

Forcimi i një angazhimi më të madh me komunitetin lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

Ofrimi i shërbimeve digitale cilësore për studentët.



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Grupet e interesit

USH ka identifikuar shumë grupe interesi të cilët përfitojnë nga shërbimet e tij, por, njëkohësisht, janë edhe kontribues në zhvillimin e mëtejshëm të USH-së. Studentët janë grupi përfitus kryesor. Nga një proces mësimor i përshtatshëm dhe mjaft profesional ata pëfitojnë një formim e zhvillim të dijeve, krijojnë dhe zgjerojnë aftësitë profesionale të duhura për t'u përballur me sfidat aktuale dhe me tregun e punës. Interesat e tyre konsistonjë në përgatitjen sa më professionale, akademike dhe praktike me qëllim të ardhshëm: arritje në karrierë dhe pozicionimin e mirë të tyre në shoqëri. Në mënyrë indirekte bizneset, OJF-të si dhe institucionet e tjera publike dhe jopublike janë përfitues të rëndësishëm, pasi ky brez studentësh do të jetë pikërisht pjesë e stafit të ardhshëm të këtyre bizneseve e institucioneve, i cili nëpërmjet një formimi të duhur kulturor, etik dhe përgatitje të përshtatshme profesionale, do të bëjë të mundur zhvillimin e këtyre strukturave dhe përballjen drejt sfidave të reja që tregu ofron. Vëtë publiku i gjere konsiderohet një grup interesit i fuqishëm për USH-në. Formimi dhe zhvillimi kulturor e profesional i studentëve të USH-së do të krijojë jo vetëm profesionistë të arritë, por edhe qytetarë të denjë për shoqërinë dhe do të kontribuojë në rrithjen e standardeve të demokracisë e të qytetarisë të shoqërisë, do të ndihmojë në zhvillimin ekonomik e social dhe në përmirësimin e cilësisë se jetës se individëve, si rrijedhojë, në mënyqenien e qytetarëve.

Kultura dhe vlerat e USH-së

Universiteti i Shkodrës ka një histori të pasur. Ai mbart vlera kulturore, unike dhe të veçanta, që e bëjnë një ndër universitetet më të kërkura në vend. Në qendër të punës së USH-së është studenti. Ai gjëzon të drejta të plota dhe të pazëvendësueshme. USH mbart një vlera të tjera, si: integritetin, besueshmërinë, suksesin, besimin, respektin, bashkëpunimin, këkkimin, inovacionin, lirinë akademike etj.

- Ne respektojmë interesat dhe aftësitë e çdo pale dhe punojmë së bashku drejt një qëllimi të përbashkët.
- Ne jemi të angazhuar të sigurojmë besim dhe respekt për të gjithë personat dhe të ndërtojmë një mjedis që kultivon integritet individual dhe institucional në çdo gjë që bëjmë.
- Ne jemi të angazhuar të sigurojmë cilësi dhe ekselencë në të gjitha përpjekjet tona.
- Ne inkurajojmë pjesëmarrje dhe partneritet.
- Ne jemi të angazhuar të vazhdojmë në zbulimin, krijimin dhe shpërndarjen e dijes si një e mirë publike.
- Ne inkurajojmë kreativitetin dhe inovacionin.
- Ne mbështesim lirinë akademike dhe respektojmë të drejtën për të shprehur opinionë të ndryshme.
- Ne sigurojmë mundësi të barabarta për të gjithë stafin dhe studentët që të arrijnë potencialin e tyre të plotë.
- Ne aplikojmë standarde më të larta etike.

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Stafi i USH-së

Një nga pikat e fortë të USH-së janë burimet njerëzore, stafi akademik dhe ai administrativ, të specializuar, të motivuar dhe produktivë. Aktualisht USH ka një staf akademik me 198 punonjës akademikë, i përbërë nga: 14 (katërmëdhjetë) me titullin *Profesor Doktor*, 36 (tridhjetë e gjashtë) me titullin *Profesor i Asociuar*, 90 (nëntëdhjetë) me gradën *Doktor*, 7 (shtatë) me gradën *Docent* dhe 51 (pesëdhjetë e një) *Asistentë lektore* me *Master i Shkencave* dhe / ose në proces doktorature.

Infrastruktura e USH-së

USH disponon një infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e funksioneve të saj administrative dhe akademike. Ajo disponon në total 9 (nëntë) objekte (ndërtesa) me një sipërfaqe të ambienteve mësimore prej 19606.9 m² gjithsej. Brenda këtyre mjedisave ka salla leksionesh, salla seminaresh, salla konferencash, salla mbledhjesh, laboratore, ambiente administrative, ambiente bibliotekë, ambiente pritëse apo çlodhëse për studentët, ambiente ndihmëse (depo, garazh etj.) oborre etj. Biblioteka Universitare ka filluar veprimtarinë e saj që me krijimin e Institutit të Lartë Pedagogjik Shkodër në vitin 1957, me një fond prej 1000 librash. Këta libra kryesisht janë në shqip. USH ka një godinë të vëçantë me tri kate për Bibliotekën Shkencore të USH-së. Ajo ka një sipërfaqe totale prej 3192 m² dhe është në përdorim 6 ditë në javë përgjatë sezoneve të provimeve, (të ndara në 5 ditë, e hënë - e prente, me 11 orë/h në ditë dhe të shturen në 5 orë).

Në brendësi të saj gjenden një sallë konferencash, tri salla leximi, një sërë zyrash, mediateka, mjidise pritëse për studentët etj. Ajo ka një kapacitet mbajtës deri në 400 000 libra. Sot biblioteka ka rrëth 170 000 njësi bibliotekare në shqip dhe në gjuhë të huaj që mbulojnë të gjitha fakultetet e USH-së. Rrëth 88 % e fondit është hedhur në katalogun elektronik (OPAC) dhe mund të aksesohet edhe nga jashtë bibliotekës. Nëse shprehemi me tituj, në fondin e BUSH në katalogun elektronik gjenden rrëth 56 mijë tituj librash dhe 457 tituj të periodikëve në gjuhë shqipe dhe të huaj. Në bibliotekë gjenden aktualisht 85000 njësi bibliotekare në gjuhën shqipe, rrëth 40 000 në gjuhë të huaj si dhe 8050 njësi në Bibliotekën Austriake. Biblioteka zoteron koleksione të pasura, si:

1. Fondin albano – balkanologjik.
2. Fondin shqip dhe të shkencave filologjike të albanologjisë.
3. PERSE-GURAKUQI
4. Bibliotekën Austriake.
5. Fondin e periodikut shqip dhe të huaj.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

6. Fondin e fakulteteve.

Vlen të cilësohet se fondi më me vlerë është fondi albano – ballkanologjik. Në këtë fond ndodhet antikuari mjaft i çmuar i bibliotekës, një ndër më të pasurit në Shqipëri, i përbërë nga 35 libra të rrallë që datojnë që nga shek. XVI. Pjesë e këtij fondi është edhe periodiku i shtypit shqiptar për periudhën 1879 – 1944, miaft i pasur gjithashu. Në arkiv ndodhen 297 tituj dhe nga këto 125 tituj janë koleksione të plota. Fondi i vjetër është në proces digitalizimi për të siguruar jetëgjatësinë e tij si dhe njëkohësisht për ta bërë atë sa më të disponueshëm për studiuesit e lexuesit. Në bashkëpunim me bibliotekën e qytetit “Marin Barleti” është krijuar portalı: “Arkivat Digitale Shkodër”, i cili do të vijë duke u pasuruar me vepra të tjera të trashëgimisë kulturore. Për më shumë ju mund të informoheni në: [eee: adsh.unishk.edu.al](http://adsh.unishk.edu.al). Pasuri dhe veçanti për Bibliotekën Universitare përbën Biblioteka Austriake, e hapur në mijediset e saj që në vitin 2000. Sot kjo bibliotekë numëron rreth 14 000 libra, periodikë dhe cd/dvd. Kjo bibliotekë mbështetet në veprimitarini e saj nga Ambasada Austriake në Tiranë dhe pasurimi i fondeve realizohet çdo vit nga Ministria Federale e Punëve të Jashtme të Austrisë. Biblioteka ofron përpërdoruesit e saj një sërë shërbimesh, si: shërbimin e informacionit dhe të huazimit, vënien e mediathekës në dispozicion të tyre, me 26 vende multimedia, si dhe tri salla leximi me 300 vende leximi në total. Godina e bibliotekës ka në përbërjen e saj edhe sallën e konferencave “Hoeflechner”, me një kapacitet 120 vende, e cila mundëson zhvillimin e një sërë aktivitetesh të karakterit akademik, mësimdhënës apo promovues. Brenda godinës është krijuar edhe një hapësirë e veçantë për bibliotekën e fëmijëve.

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Strategjia e zhillimit të USH-së (2022-2026) është mbështetur në disa prioritete mbi të cilat janë ndërtuar edhe strategjitë sektoriale të USH-së. Këto prioritetë janë identifikuar mbi analizën e situatës së shkuar dhe të tashme të USH-së dhe zgjerojnë potencialet për zhvillimin e aktiviteteve të reja të stafit, studentëve, departamenteve etj. Objektivat e kësaj strategjje janë në një linjë me objektivat e strategjisë kombëtare të arsimit gjatë periudhës 2022-2026.

1. RRIJJA E CILËSISË

2. PËRSOSMËRIA NË MËSIMDHËNIE DHE KËRKIM

3. NDËRLIDHJA ME TREGUN E PUNËS

4. INTEGRITETI DHE TRANSPARENCA

5. STUDENTËT

6. NDËRKOMBËTARIZIMI I USH-së

7. SHËRBIMET DIGITALE

SHKODRË
UNIVERSITETI

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI” 2022-2026

Objektivi specifik 1: Rritja e cilësisë

Sigurimi i cilësisë në USH është i organizuar nëpërmjet një sërë procesesh themelore që ndikojnë në realizimin e plotë të procesit akademik dhe në zhvillimin perspektiv të kurrikulave universitare; të proceseve themelore të vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit dhe akreditimit institucional, mbështetur në dokumentacionin ligor të arsimit të lartë dhe aktet nënligjore të MASR dhe aktet e tjera nënligjore, vendimeve e udhëzimeve të strukturave drejtuese të USH-së dhe në fymrën e standardeve evropiane të cilësisë.

Sigurimi i cilësisë në USH ka evoluar për t'u bërë një nga përaparësitë kryesore të politikave të arsimit të lartë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është detyrim ligor i USH-së, i cili është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë. Aplikimi i proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë synon përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësuarit në USH. Ndërsa, sigurimi i jashtëm i cilësisë, është përgjegjësi e ASCAL-it dhe realizohet nëpërmjet akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka 63 (gjashtëdhjetë e tre) programe studimi, të cilët, nga aspekti strukturor, ndjekin praktikat e vendeve anëtare të Procesit të Bolonjës. Si të tillë, këto programe, kanë nevojë për rishikim të vazhdueshëm dhe përshtatje me nevojat e kohës. Ndërsa, infrastruktura e akademike e përbëjnë godinat, pajisjet, kabinetet, laboratorët e biblioteka që janë në shërbim të personelit akademik dhe të studentëve. Modernizimi i kësaj infrastrukturë ndikon edhe në cilësinë e realizimit të programeve të studimit.

Duke u mbëshitetur në përshtrimin e mësipërm mbi sfidën që ka USH-ja në arrijen e cilësisë, në vijim po parashtrojmë objektivat për periudhën 2022-2026.

- **Objektivat**
 - Përmirësimi i infrastrukturës akademike.
 - Aplikimi i standardeve të larta akademike për akreditimin e IAL-ve dhe të programeve studimore.
 - Akreditimi i USH-së dhe programeve në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e institucionit dhe programeve të akredituara do të garantonjë përmirësim të përputhshmërisë të cilësisë së arsimit të lartë me standaret dhe udhëzuesit për sigurim të cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Më poshtë është paraqitur plani strategik për përbushjen e objektivave të mësipërme.



STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

- Objektivi I. Përmirësimi i infrastrukturës akademike.

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet									
I.I Investime në zgjerimin e përmirësimin e infrastrukturës akademike (godinat, laboratorët, kampus, muzeumi i USH-së etj); përshtatje e godinave për persona me aftësi të kufizuara; pasurim me sinjalistikë të secilës godinë të USH-së.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i projekteve për rikonstruktum të godinave të depozitura e MAS. ➤ Projekti për kampus universitar i depozituar në MAS. ➤ Numri i godinave rikonstruktuarë më qëllim të lëvizjes optimale të personave me aftësi të kufizuar. ➤ Pajisja e çdo fakulteti me bibliotekën përkatëse, me fond më gjuhë shqipe dhe të huaj. ➤ Sinjalistika në secilën godinë. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektorati ➤ Dekanatet ➤ Departamentet ➤ Zyra e Kurrikulave dhe Standardeve të cilësisë 	5 vite akademi ke	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare në realizimin e projekteve. 									
II.I Aplikimi i standardeve të larta akademike për akreditimin e USH-së dhe të programeve të studimit.	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th>Aktivitet</th> <th>Indikatorët/Vlerat Target</th> <th>Përgjegjësia</th> <th>Koha</th> <th>Risqet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>II.I Aplikimi i standardeve të larta akademike (të reja) në programet e studimit brenda shkollës në vlerësimin e brendshëm të USH-së.</td> <td> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Rishikim i programeve të studimit, i literaturres që ofrohet për studentët si dhe cilësia e laboratorëve. ➤ Numri i pedagogëve dhe i studentëve të përfshirë. ➤ Numri i punonjësve të administritës të përfshirë. </td><td> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektorati ➤ Biblioteka ➤ Fakultetet ➤ Departamentet </td><td>Një herë në vit</td><td> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare e përditësimit të tyre. </td></tr> </tbody> </table>	Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet	II.I Aplikimi i standardeve të larta akademike (të reja) në programet e studimit brenda shkollës në vlerësimin e brendshëm të USH-së.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rishikim i programeve të studimit, i literaturres që ofrohet për studentët si dhe cilësia e laboratorëve. ➤ Numri i pedagogëve dhe i studentëve të përfshirë. ➤ Numri i punonjësve të administritës të përfshirë. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektorati ➤ Biblioteka ➤ Fakultetet ➤ Departamentet 	Një herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare e përditësimit të tyre. 		
Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet									
II.I Aplikimi i standardeve të larta akademike (të reja) në programet e studimit brenda shkollës në vlerësimin e brendshëm të USH-së.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rishikim i programeve të studimit, i literaturres që ofrohet për studentët si dhe cilësia e laboratorëve. ➤ Numri i pedagogëve dhe i studentëve të përfshirë. ➤ Numri i punonjësve të administritës të përfshirë. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektorati ➤ Biblioteka ➤ Fakultetet ➤ Departamentet 	Një herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare e përditësimit të tyre. 									

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Objektivi III. Akreditimi i USH-së dhe programeve të studimit në vazhdimësi.

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
III. 1 Akreditimi i USH-së.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Monitorimi dhe përbushja e rekomandimeve të lëna në raportin e akreditimit të USH-së në vitin 2020. ➤ Zyra e Sigurimit të cilësisë dhe Vlerësimit të standardeve. ➤ Rektorati ➤ Fakultetet ➤ Departamentet 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Komisioni përgjegjës për standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit. ➤ Zyra e Sigurimit të cilësisë dhe Vlerësimit të standardeve. ➤ Rektorati ➤ Fakultetet ➤ Departamentet 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ 2024 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare për realizimin e akreditimit. ➤ Vështirësi të koordinimit mes grupeve të ndryshme.
III. 2 Akreditimi i programeve të studimit që ofron secili fakultet.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Hartimi i RVB-ve për se cilin program studimi që do të akreditohet. ➤ Numri i evidencave për akreditim të programeve nga departamentet. ➤ Numri i programeve të akredituara. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektorati ➤ Departamentet ➤ Zyra e Sigurimit të cilësisë dhe Vlerësimit të standardeve 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Brenda afateve ligjore 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare për realizimin e akreditimit të të gjitha programeve të studimit. ➤ Vështirësi të koordinimit mes grupeve të ndryshme.
III. 3 Hartimi i raportit të vlerësimit të brendshëm të fakultetit çdo vit.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Raporti i vlerësimit të brendshëm të fakultetit. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektorati ➤ Fakultetet ➤ Departamentet 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Cdo vit akademik 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Respektimi i afateve kohore.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Objektivi specifik 2: Përsosmëria në mësimdhënie dhe kërkim

Nevoja për t'i dhënë theks më të lartë mësimdhënie cilësore, të mësuarit me në qendër studentin dhe përdorimit të metodave inovative të mësimdhënie janë tashmë domosdoshnëri në praktikat institucionale të mësimdhënie. Synohet pënmirësimi i përbajtjes së kërkimit shkencor, mbështetur në pëparësitet kombëtare dhe nën optikën e pëparësive aktuale të zhvillimit të vendit. Veprimtaria kërkimore-shkencore, synon rritjen e cilësisë së arsimit, duke krijuar mundësi që personeli akademik dhe studentët të fitojnë aftësi për këkim e pavurura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshmë profesional dhe të karrierës akademike. Analiza e situatës në fushën që mbulon ky objektiv specifik e sheh kërkimin shkencor, si komponent të rëndësishëm kyç për institucionet e arsimit të lartë, është veprimtari që varet nga nismat individuale. Përsa i përket avancimit në karrierën akademike mund të thuhet që mbështetet kryesisht në tregues që kanë të bëjnë me publikimet, përfshirjen në projekte të ndryshme kërkimore shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, ndërsa performance në fushën e mësimdhënie konsiderohet si kriter dytësor.

USH synon sigurimin e një mësimdhënieje cilësore dhe përfshirje më të madhe në drejtim të kërkimit shkencor nga ana e pedagogëve dhe studentëve si dhe rritje të konkurrencës së diplomave të USH-së në tregun e punës. Gjithashtu USH synon zhvillimin dhe implementimin e një strukture të qëndrueshme akademike për një ambient të përshtatshëm mësimi dhe kërkimi shkencor për stafin dhe studentët, rritjen e numrit të studentëve cilësorë që zgjedhin për të studuar në USH, rritjen e numrit të studentëve që ndjekin ciklin e dytë të studimeve. Kjo strategji do të ndihmojë për pënmirësimin e performancës së Universitetit duke ofruar diploma cilësore në tregun e punës, rritjen e rolit komunitar të universitetit, sigurimin e një procesi të të mësuarit të vazdueshëm për profesionistët e shërbimeve të ndryshme, të cilët ndikojnë në rritjen e cilësisë së jetës akademike dhe intelektuale.

Duke u mbështetur në përshkrimin e mësipërm mbi sfidën që ka USH në arrijen e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim, në vijim po parashtrojmë objektivat për periudhën 2022-2026.

Objektivat

- Përmirësimi i kapacitetit të personelit akademik për mësimdhënie dhe kërkim shkencor.
- Krijimi i qendrave në IAL për trajnimin në mësimdhënie dhe kërkim.
- Zbatimi i incentivave për rezultate në punën shkencore.
- Përfshirja e studentëve të Doktoraturës dhe në nivel Master në kërkim shkencor.

Më poshtë është paraqitur plani strategjik për përbushjen e objektivave të mësipërmme.

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIJ GURAKUQI" 2022-2026

- *Objektivi I. Përmirësimi i kapacitetit të personelit akademik për mësimdhënie dhe kërkim shkencor.*

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
II.1 Përfshirja në mobilitetet jashtë vendit të të gjithë stafit akademik.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i stafit të përfshire në mobilitete. ➤ Zyra e Marrëdhënieve me jashtë 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektori ➤ Departamentet ➤ Zyra e Marrëdhënieve me jashtë 	Çdo vit akademik	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i kufizuar i projekteve të mobiliteteve.
III.1 Ngritja e sistemit të vlerësimit të performancës 360° për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pështime.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerësim performance për çdo pedagog me kohë të plotë dhe të pështime. ➤ Zyra e Burimeve njerëzore 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektorati ➤ Dekanatet ➤ Departamentet 	Çdo vit akademik	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare e përditësimit të tyre.

Objektivi II. Ofrimi i programeve për trajnimin në mësimdhënie dhe kërkim.

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
II.1 Ofrimin e programeve trajnuese për ngritje kapacetitesh brendshme (komunikim, ICT, menaxhim, kërkim shkencor, redaktim etj.) sipas profileve fakulteteve, specializuara trajnimin akademik e stafit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i pedagogëve dhe i studentëve të përfshire. ➤ Numri i punonjësve të administratës të përfshire. ➤ Numri i ekspertëve të përfshire për të realizuar trajnime. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektorati ➤ Biblioteka ➤ Fakultetet ➤ Departamentet ➤ Drejtoria e Kurrikulave, Këkimit shkencor dhe Standardeve 	Çdo vit akademik	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare.

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Objektivi III. Zbatimi i incentivave për rezultate në punën shkencore.

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
III. 1 Financim i projekteve kërkimore për pedagogët që janë pranë marrjes së titujve akademikë.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Akordimi i mbështetjes financiare për projektet kërkimore. ➤ Pjesëmarrje në konferanca ndërkombëtare. ➤ Numri i punimeve në revista të indeksuara në Scopus dhe EoS. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Senati Akademik akademik ➤ Bordi i Administrimit ➤ Fakultetet ➤ Departamentet ➤ Zyra e Projekteve ➤ Zyra e Burimeve njerezore 	Cdo vit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Fondë të pamjaftueshme për realizimin e financimit të projekteve kërkimore.
III. 2 Financim i projekteve kërkimore për pedagogët që janë të angazhuar në kërkim shkencor.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Akordimi i mbështetjes financiare për projektet kërkimore. ➤ Pjesëmarrje në konferanca ndërkombëtare. ➤ Numri i punimeve në revista të indeksuara në Scopus dhe EoS. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Senati Akademik ➤ Bordi i Administrimit ➤ Fakultetet ➤ Departamentet ➤ Zyra e Projekteve ➤ Zyra e Burimeve ➤ Njerëzore 	Cdo vit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Fondë të pamjaftueshme për realizimin e financimit të projekteve kërkimore.

Objektivi IV. Përfshirja e studentëve të programeve të ciklit të dytë në kërkim shkencor.

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
IV. I Rritja e përfshijes së studentëve të	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i studenteve të përfshirë në kërkim shkencor. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektorati ➤ Dekanatet 	Cdo vit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Përfshirja e ulët e studentëve.

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

<p>programeve të ciklit të dytë dhe të tretë në kërkim shkencor.</p> <p>IV.2 Financimi i projekteve kërkimore për studentët e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Akordimi i mbështetjes financiare për projektet kërkimore. ➤ Realizimi i punimeve shkencore ose i projekteve kërkimore. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Departamentet ➤ Senati Akademik ➤ Bordi i Administrimit ➤ Fakultetet ➤ Departamentet ➤ Zyra e Projekteve ➤ Zyra e Burimeve njerëzore 	<p>Çdo vit</p>	<p>➤ Fondet pë realizimin e financimit të projekteve kërkimore.</p>
---	--	--	----------------	---

Objektivi specifik 3: Ndërlidhja me tregun e punës

Një ndër objektivat themelorë të USH-së është diplomimi i studentëve të cilët zotërojnë aftësitë e nevojshme për të qenë të sukseskënë në tregun e punës. Një objektiv i tilë është në pëputhje të plotë me prishmërinë kryesore të studentëve, sigurimin e një vendi përsëri përfundimtë të studimeve (OECD, 2017). Por ky objektiv merr akoma më shumë vlerë në kushtet e sotme të globalizimit të ekonomisë dhe orientimit të saj drejt inovacionit të bazuar në aftësitë e punonjësve.

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Një seri e gjërë publikimesh shkencore dhe politike i kanë kushtuar vëmendje dhe janë përpjekur të kuptojnë rëndësinë e lidhjes mes arsimimit të lartë dhe tregut të punës, brenda një konteksti të gjërë e që përfshin një mori institucionesh, duke vënë theksin tek impakti i kësaj lidhjeje në zhvillimin ekonomik të vendeve (Cleary & Van Noy, 2014). Sipas Cleary & Van Noy (2014) përputhja e arsimit të lartë me tregun e punës nënkupton “tëresinë e aktivitetave dhe pasojaqe që rrijedhin prej tyre, të cilët bëjnë të mundur që institucionet e arsimit të lartë (IAL) të diplomojnë numrin e duhur të studentëve dhe me aftësitë e nevojshme për tregun e punës, në një mënyrë që është në linjë me objektivat e studentëve dhe me misionin e kushtet ekonomike të institucioneve”. Megjithëse një përkufizim i tillë mund të shërbejë si udhërrëfyes për një IAL, duhet patur parasysh që nuk ka një qasje të vetme rmbi atë sesi vlerësohet “numri i saktë i studentëve” dhe “aftësitë” e tyre në shërbim të tregut të punës. Siç e theksojnë vetë autorët, përputhja e IAL-ve me tregun e punës mund të realizohet në mënyra të ndryshme, në varësi kjo të kontekstit të IAL-ve dhe mjesdit ku ato veprojnë.

Sipas një raporti të Komisionit European mbi lidhjen mes tregut të punës dhe IAL-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor (Barlett et al., 2016), rezulton që sistemet e arsimit të lartë në këto vende karakterizohen nga një seri sfidash, ndër të cilat, rritja e numrit të studentëve, që duket se po shteron burimet e kufizuar të universiteteve publike. Kështu, në vitin 2016, rezultonte që numri i studentevë të regjistruar në të gjitha IAL-të e vendeve të Ballkanit Perëndimor të ishte rrëth 750.000 vetë. Në të njëjtën kohë, rapporti evidenton një rritje në numrin e biznesve private në këto vende dhe të nevojave të tyre për punonjës të kualifikuar, por që nuk mund të plotësohen pasi studentët e diplomuar nuk zotërojnë aftësitë e kërkuar nga bizneset. Po kështu, vihet re që pasja e një diplome universiteti në këta vende rrit shanset për punësim të të rinjve. Norma e papunësisë mes të diplomuarve ishte 16.2%, krahasuar me normën e përgjithshme të papunësisë prej 23.9%. Megjithatë, norma e papunësisë mes të sapodiplomuarve ishte relativisht e lartë, rrëth 37%, duke sugjeruar që integrimi i tyre në tregun e punës nuk është i lehtë. U vu re që studentët e sapodiplomuar hasnin vështirësi për të hyrë shpejt në tregun e punës e veçanërisht për të sigurar punësimin në fushën ku ishin diplomuar apo specializuar. Këto karakteristika të tregut të punës dhe marrëdhënie së tij me IAL-të, rezultuan po kaq të dukshme edhe në rastin e Shqipërisë. Raporti thekson që edhe në rastin e vendit tonë vihet re një rritje e kondiderueshme e numrit të studentëve të regjistruar çdo vit, në një kohë që vëtëm rrëth 53% e tyre arrinë të diplomohen. Sipas raportit, që pasqyron edhe rezultatet sondazhevë të bëra me studentë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, rezulton që studentët shqiptarë i konsiderojnë tradicionale metodat e mësimdhënieς në universitetë dhe kurrikulat e tyre shpeshtë të vietëruara, duke mos iu përgjigjur këshfu kërkessave të tregut të punës. Ka një tejm bushje të tregut të punës me të diplomuar në fusha, si, mjekësia, artet, administrim-biznesi, drejtësia, dhe arsimi, në një kohë që ka mungesë të të diplomuarve në shkencat natyrore, matematikë dhe statistikë, shkencat shoqërore dhe në komunikim e gazetari. Këtë e vërtetojnë edhe të dhënat e INSTAT mbi numrin e studentëve të regjistruar sipas fushave të studimit në IAL-të shqiptare gjatë periudhës 2016-2021, të kategorizuara sipas viteve akademike.



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJGJ GURAKUQI” 2022-2026

Numri i studenteve te regjistruar sipas fushave të studimit




Figura 1.
INSTAT¹

■ 2015-16 ■ 2016-17 ■ 2017-18 ■ 2018-19 ■ 2019-20 ■ 2020-21

Burimi:

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, i vendosur në qendrën historike dhe kulturore të Rajonit të Veriut të Shqipërisë, ka shërbyer dhe vazhdon të jetë burimi kryesor i profesionistëve në fusha të ndryshme, si:

- mësuesi (arsim parashkollar, arsim fillor, biologji kimi, matematikë-fizikë, gjuhë-letërsi, histori-gjeografi, edukim fizik dhe albanologji);
- ekonomi (administrim biznes, finance, kontabilitet, turizëm);
- drejtësi;
- shërbime sociale (psikologji, punë sociale);
- shëndetësi (infermieri, mami, fizioterapi);
- mjedisi dhe IT;
- gazetari.

¹ <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/#tab2>

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIJGJ GURAKUQI" 2022-2026

Krahas fushave të larpermendura, Universiteti i Shkodrës ofron programe studimi që përgatisin specialistë në biologji, kimi, matematikë, fizikë, gjuhësi, letërsi, histori, gjeografi, edukim fizik dhe sporte, arti plamor, pikture dhe grafikë, gjuhë angleze, gjuhë gjermane, gjuhë frëngje, gjuhë italiane, si dhe specialistë muzeumesh dhe guidash turistike, punonjës bibliotekë, ekspertë njedisi.

Universiteti i Shkodrës ka 6 (gjashtë) fakultete, të cilët ofrojnë këto programe studimi:

- cikli i parë: Bachelor;
- cikli i dytë: Master Profesional, Master i Shkencave;
- cikli i tretë: Doktoraturë;
- programe studimi me karakter profesional.

Të diplomuarit në këto programe kanë mundësi të punësohen në fushat e mëposhtme:

Arsimi

Arsimi (publik dhe privat) është një prej sektorëve ku mund të punësohen një pjesë e konisderueshme e të diplomuarve të Universitetit të Shkodrës. Një sërë programesh studimi që ofron ky universitet synojnë përgatitjen e mësuesve për arsimin parashkollor dhe fillor, për arsimin parauniversitar në shkencat e natyrës, shkencat shoqërore dhe gjuhët e huaja. Të diplomuarit në këto fusha kryesisht gjijnë treg pune në mësimdhënie (arsim publik dhe privat parauniversitar), punonjës në administratën publike dhe institucione të shumta private.

- Albanologjia

Studimet albanologjike janë prioritet me rëndësi për strategjinë e zhillimit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Fakulteti i Shkencave Shoqërore ofron programe studimi në nivel Bachelor dhe Master i Shkencave në fushat albanologjike: gjuhë shqipe-letërsi, gazetari, histori, trashëgimi kulturore, gjeografi; Master Profesional në mësuesi. Të diplomuarit në këto profile kanë mundësi të punojnë si mësues, kërkues shkencorë, pedagogë universitarë, ekspertë të arsimit, historisë, shtypit, gjeografisë, trashigimisë kulturore etj., redaktorë gjuhësorë dhe letrarë, punonjës muzesh, bibliotekash, gazetarë, zëdhënës shtypi, nëpunës në nivele të ndryshme të administratës lokale dhe qendrore etj. Pranë këtyj fakulteti, Qendra e Studimeve Albanologjike, mbështet punën kërkimore-shkencore në këtë fushë.

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

punësuar në të gjitha degët e bankave të nivelit të dytë në Rajonin e Veriut, në institucionet e qeverisjes vendore, si: bashki, prefekturë e qark, në institucionet e tjera të shërbimit publik, si dhe në shumë biznese të tjera që ushtrojnë aktivitetin në këtë rajon dhe më gjere. Ata mbulojnë pozicionë nga më të ndryshmet, duke filluar që me pozicionin e specialistit e duke mbërritur deri në nivel të larta menaxheriale të institucioneve të ndryshme publike apo bizneseve.

- Drejtësia

Universiteti i Shkodrës ofron programe studimi që sigurojnë përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar në disa profile të fushës së drejtësisë. Të diplomuarit mund të punësohen pranë strukturave të drejtësisë të tilla si: prokurori, gjykata, institucione të ndryshme publike dhe private ku ofrojnë shërbimet e tyre juridike. Mundësi alternative punësimi për ta janë edhe figurat e profesionistit të lire, të tillë, si avokat, noter, konsulent, etj.

- Shërbime sociale

Universiteti i Shkodrës ofron programe studimi në nivel bachelor dhe master në fushën e shkencave sociale. Të diplomuarit e Universitetit të Shkodrës në këtë fushë kanë mundësi të punojnë si psikologë dhe punonjës socialë në institucionet e tillë, si: spitalë, jetimore, shtëpi për të moshuar, polici, burgje, qendra rehabilitimi, gjykata, ushtri, çerdhe, kopshte, shkolla, konsultore e klinika si dhe organizata të ndryshme të shërbimeve sociale.

- Shëndetësia

Universiteti i Shkodrës ofron programe studimi në fushat mjekësore. Tregu i punës në shëndetësi ofron mundësi punësimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë për të diplomuarit në këto fusha. Ata punësohen kryesisht në spitale shtetërore dhe private, qendra shëndetësore (Shërbimi i Shëndetësor parësor), shërbimi i shëndetit mendor, Drejtorinë e Shëndetit publik, laboratorë dhe qendra diagnostikuese etj. Në kuadër të pandemisë globale, roli i figurave profesionale mjekësore është ridimensionuar, duke çuar në rritjen e nevojës për shërbime shtesë shëndetësore e si rrijedhojë edhe të kërkuesës për profesionistë në këtë fushë.

- Mjedisi dhe IT

Dy fushat që vitet e fundit po shihen me prioritet janë edhe ajo e mbrojtjes së mjesdit dhe e IT-së. Duke patur parasysh burimet natyrore të rajonit dhe nevojën për të zhvilluar një turizëm të qëndrueshëm, i cili mbështetet në zhvillimet e teknologjisë së informacionit e që sjell burime ekonomike për komunitetin e tij, programet e ndryshme të ofruara nga fakultetet e Universitetit të Shkodrës janë përshtatur me këtë tendencë. Të diplomuarit në këto programe kanë mundësinë të punësohen në institucionet e ndryshme publike apo private që po i përshtaten tendencës së sipërpermendur.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Duke u mbështetur në përshkrimin e mësipërm mbi sfidën e lidhjes mes universitetit dhe tregut të punës, si edhe të kompetencave me të cilat formohen studentët e USH-së, në vijn po parashtrojmë objektivat e strategjisë së tregut të punës së USH-së për periudhën 2022-2026.

Objektivat

- Përshtatja e kurrikulave me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.
- Bashkëpunimi i ngushtë me punëdhënësit për të njohur më mirë nevojat dhe tendencat e tregut të punës.
- Orientimi, këshillimi dhe zhvillimi i karrierës për studentët e tij që nga fillimi i studimeve në përputhje në nevojat dhe tregut të punës.
- Krijimi i infrastrukturave që sigurojnë lidhjen me komunitetin dhe shërbimet ndaj tij.

Më poshtë është paraqitur plani strategjik për përbushjen e objektivave të mësipërme.

Objektivi I. Përshtatja e kurrikulave me nevojat dhe kërkesat e tregut e punës.

Aktivitetet	Indikatorë/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
1.1 Rishikimi i kurrikulave në përputhje me nevojat e tregut të punës (hapja e programeve të reja si Master në studime të AK ² , Master në studime gjeriatrike ³).	<ul style="list-style-type: none"> > Numri i ndryshimeve të reflektuara në programet ekzistuese. > Numri i programeve të reja të hapura gjatë një viti akademik. 	<ul style="list-style-type: none"> > Dekanatet Departamentet Infermieri, Psikologji dhe Sociale > Zyra e Kurrikulave dhe Standardeve të cilësisë 	1 vit	<ul style="list-style-type: none"> > Ndryshim i ngarkesave të stafit akademik.
1.2	<ul style="list-style-type: none"> > Numri i programeve të studimit të ofruara online. 	<ul style="list-style-type: none"> > Dekanatet > Departamentet 	1 vit akademik	<ul style="list-style-type: none"> > Ndryshim i ngarkesave të stafit akademik.

² Studimet përafshinë e kufizuar eksplorojnë mënyrat në të cilat jeta e njerëzve me aftësi të kufizuara formësohet nga modellet e padrejtësisë, përfashtimit dhe distancimit dhe "normave" sociale, kulturore dhe estetike.

³ Ky program është krijuar për të ritur njohuritë dhe aftësitë e nxënësve për të punuar me të riturit të moshës, në mënyrë që të plotësohen në mënyrë efektive nevojat e populatës në plakje. Ky program do të fokusohet në fitimin e një kuptimi më të madh të nevojave fizike, sociale, njohëse dhe shpirtore të të moshaqarve dhe sfidave me të cilat përballet popullsisë jonte në plakje.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Ofrimi i disa programeve të studimit në distancë.

- Numri i studentëve përfitues.

Objektiivi II. Bashkëpunimi i ngushtë me punëdhënësit për të njoftur më mirë nevojat dhe tendencat e tregut të punës.

Aktivitetet	Indikatorët/Vlerat	Përgjegjësia	Koha	Risqet
		Target		
II.1 Studim i vazhdueshëm i tregut të punës në rang fakulteti.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i institucioneve publike dhe private, pjesëmarrëse në studim. ➤ Numri i bizneseve dhe institucioneve publike, pjesëmarrëse në panair. ➤ Numri i studentëve të përfshirë. Përfundimet në lidhje me pritshmëritë e studentëve, të dala nga Panairi i Punës. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Fakultetet ➤ Rektorati ➤ Zyra e Karrierës - Alumni 	1 vit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mungesë e të dhënavë, kosto kohore dhe financiare e përditësimit të tyre.
II.2 Zhvillimi i Panairit të Punës në rang fakulteti.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Fakultetet ➤ Departamentet 	Një herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Gratishmëri e pakët e institucioneve publike dhe bizneseve për të marrë pjesë në panair. ➤ Besueshmëri e ulët e institucioneve, biznesit dhe studentëve në efektivitetin e Panairit. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vështirësi bashkëpunimi nga ana e bizneseve apo institucioneve publike.
III.3 Planifikimi dhe koordinimi i praktikave profesionale/ekspeditive në përputhje me tregun e punës.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i praktikantëve në institucionë publike, private dhe biznese. ➤ Feedback-u i studentëve dhe punëdhënësve. ➤ Numri i studentëve të punëuar në të njëjtin institucion pas praktikës. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Sektori i Komunikimit i Marrëdhënieve me jashtë dhe Projekteve ➤ Fakultetet ➤ Departamentet 	Një ose dy herë më vit, sipas struktures mësimore	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vështirësi bashkëpunimi nga ana e bizneseve apo institucioneve publike.
Objektiivi III. Orientimi, këshillimi dhe zhvillimi i karrierrës së studentëve që në filimin e studimeve në përputhje me nevojat e tregut të punës		Indikatorët/Vlerat	Përgjegjësia	Risqet
Aktivitetet	Target		Koha	

SHKODË

23

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

<p>III. 1 Vënia në eficencë të plotë të zyrës së këshillimit dhe karierës.</p> <p>III. 2 Hartimi dhe shpërndarja e materialeve udhëzuese për orientimin e studentëve gjatë dhe pas studimeve.</p> <p>III. 3 Gjurmimi i të dhënave mbi punësimin aktual të alumini-ve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ► Aktivitetet dhe takimet orientuese organizuar nga grupet përkatëse. ► Hartimi i guidës për studentët në rang universiteti. ► Hartimi i guidës për studentët në rang fakulteti. ► Aktivitetet e zhvilluara me alumni ndër vite. ► Rektorati ► Fakultetet 	<p>1 Vit akademik</p> <p>1 vit akademik</p>	<ul style="list-style-type: none"> ► Fakultetet Departamentet ► Gjetja e fondeve për realizimin e guidës. ► Vonesa e përditësimit me të dhënrat e studentëve.
Objektivi IV. Krijimi infrastrukturave që sigurojnë lidhjen me komunitetin dhe shërbimet ndaj tij.			
<p>Aktivitetet</p> <p>IV. 1 Ngrija e Inkubatorit të Bизнесит (pranë FE-së).</p> <p>IV. 2 Ngrija e laboratorit të Ushqimeve dhe Pijeve (pranë FE-së dhe në kuadër të bashkëpunimit të FE-së me Sandhill Community College).</p>	<p>Indikatorët/Vlerat</p> <p>Target</p> <ul style="list-style-type: none"> ► Numri i bizneseve të përfshira. ► Numri i start-up-ve të krijuara rishtazi. ► Të ardhurat e gjenieruara për fakultetin. <p>Përgjegjësia</p> <ul style="list-style-type: none"> ► Fakulteti ► Departamentet <p>Koha</p> <p>2-3 vite</p> <p>2-3 vite</p> <p>Risqet</p> <ul style="list-style-type: none"> ► Mosgjetja e fondeve për ngrijen e inkubatorit. ► Mungesa e autonomisë financiare. ► Vështirësi përpunje te aktiviteteve me bazën teorike. ► Fakulteti ► Departamentet 	<p>1 Vit akademik</p> <p>1 vit akademik</p>	<ul style="list-style-type: none"> ► Ndariaj dhe mungesa e komunikimit midis grupeve të ndryshme. ► Interes i pakët nga bizneset e rajonit.
<p>V. 3 Vështirësi qëndrueshmë e gjendrës së Inovacionit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ► Numri i aktiviteteve të zhvilluara me fokus turizmin e qëndrueshmë. 	<p>2-3 vite</p>	<ul style="list-style-type: none"> ► Fakulteti ► Departamentet

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

<p>për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshmëm.</p> <p>IV.4 Ngrija dhe vënia në eficiencë e qendrës USIA.</p> <p>IV.5 Ngrija dhe vënia në eficiencë e laboratorit të Analizës ushqimore.</p> <p>IV6. Vënia në eficiencë e Klinikës së Fizioterapisë.</p> <p>IV.7 Vënia në eficiencë të plotë të Klinikës së Ligit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ► Numri i biznesve turistike të përfshira. ► Numri i projekteve të gjenierara për zhvillimin e turizmit të qëndrueshmëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. ► Numri i grupeve të interesit që bashkëpunojnë me këtë qendër, si atyre publike ashtu edhe private, në fushën e qeverisjes vendore, biznesit dhe medias. ► Numri i studentëve dhe pedagogëve të përfshirë. ► Të ardhurat e gjenierara për USH-në. 	<p>2-3 vite</p> <ul style="list-style-type: none"> ► Numri i grupeve të interesit që bashkëpunojnë me këtë qendër, si atyre publike ashtu edhe private. ► Numri i studentëve dhe pedagogëve të përfshirë. ► Të ardhurat e gjenierara për USH-në. 	<p>2-3 vite</p> <ul style="list-style-type: none"> ► Rektorati ► Fakultetet ► Gatishmëria për bashkëpunuar nga aktorët e qeverisjes lokale, biznesit dhe medias lokale. 	<p>Vështirësi në bashkëpunim me institucionet e qeverisjes lokale.</p> <p>Mosjetja e fondeve të nevojshtme për vënien në eficiencë të qendrës.</p> <p>Vështirësi në vënien në eficiencë të qendrës.</p> <p>Gatishmëria për bashkëpunuar nga aktorët e qeverisjes lokale, biznesit dhe medias lokale.</p>
			<ul style="list-style-type: none"> ► Fakulteti ► Departamenti ► Konkurenca në treg. 	<ul style="list-style-type: none"> ► Fakulteti ► Departamenti ► Konkurenca në treg.

25

Fakulteti

Brenda
2022

Konkurenca në treg.

Numri i përfituesve.

Brenda
2022

Konkurenca në treg.

Numri i përfit

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Ngritura e Klinikës së Shërbimit psikologjik dhe social. <p>IV. 9 Akreditimi i laboratorit Mikrobiologjik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i studentëve pedagogëve të përfshirë. ➤ Certifikimi i laboratorit. ➤ Numri i përfitesve në komunitet. ➤ Numri i studentëve pedagogëve të përfshirë. 	<ul style="list-style-type: none"> dhe në dhe dhe 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale ➤ Fakulteti ➤ Departamentet ➤ Qendra e Studimeve të Ujërave të Rajonit të Shkodrës 	<ul style="list-style-type: none"> Brenda 2022 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mungesa e autonomisë financiare.
IV. 10 Certifikimi i njohjes së guhës shqipe, gjuhëve të huaja si dhe njohurive të caktuara në fusha të ndryshme.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i përfitesve komunitet. ➤ Numri i studentëve pedagogëve të përfshirë. 	<ul style="list-style-type: none"> në dhe 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rektorati ➤ Fakulteti ➤ Departamentet 	<ul style="list-style-type: none"> Dhjetor 2022 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Konkurranca në treg.

Shënim:

a) *Inkubatori i Biznesit*

Strukturë e ngritur pranë FE-së përmblledhjen dhe gjenerimin e ideve të biznesit, në bashkëpunim me komunitetin rajonal të biznesit. Sigurim trajnimi, konsulencë përbiznesin dhe mbështetje për startup-et. Një mundësi përsigurimin e mësimdhënies me karakter praktik, zhvillimin e praktikës profesionalë, punësimin e studentëve dhe gjenerimin e të ardhurave përfshirë.

b) *Laboratori i Ushqimeve dhe Pijeve*

Në kuadër të bashkëpunimit të FE-së me Sandhills Community College, me ekspertizë në fushën e menaxhimit hotelier, do të zhvillohen dhe marketohen idetë më të mira në fushën e gastronomisë, duke siguruar mundësi praktike dhe punësimi për studentët dhe gjeneruar të ardhura përfshirë.

c) *Qendra e Inovacionit për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm*

Ukjo qendër është ngritur, në kuadër të projektit FOST INNO, si pjesë e rrijetit të qendrave të ngritura në rajonin Adriatiko-Jonian, për të mbështetur zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Kjo qendër aktualisht ka nënshkrar marrëveshje me operatorët lokalë në fushën e biznesit, ndërsa në të ardhmen prashikon zhvillimin e një sërë aktivitetesh me pjesëmarjen e studentëve, stafit dhe aktorëve publikë e

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI” 2022-2026

private të rajonit që lidhen me fushën e turizmit. Në mënyrë të veçantë kjo qendër do të shërbejë si urë lidhëse mes punës kërkimore në kuadrin e shkollës doktorale pranë FE-së dhe mjesdit të biznesit në Rajonin e Veriut. Ajo gjithashu siguron lidhje me biznesin, mundësi trajnimi me eksperitzë ndërisipratinare në mbështetje të turizmit të qëndrueshëm, mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale etj.

d) Qendra USIA

Qendra USIA një strukturë brenda USH-së me symim rritjen e bashkëpunimit me përfitim reciprok mes USH-së dhe qeverisjes lokale, komunitetit të biznesit dhe medias. Siguron promovimin e punës kërkimore të pedagogëve dhe studentëve të USH-së dhe vënien e saj në dispozicion të aktorëve të sipërpërmendur. Pëmireson lidhjet e USH-së me komunitetin e grupet e interesit, mit reputacionin e tij në komunitet dhe krijon ura lidhëse për zhvillimin e praktikave profesionale dhe punësimin e ardhshëm të studentëve.

e) Klinika e Ligjit

Bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër dhe LëvizAlbania është themeluar dhe ushttron funksionet e veta Klinika e Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Klinika e Ligjit synon të ofrojë ndihmë juridike falas për personat në pamundësi ekonomike, duke ofruar ndihmë ligjore parësore dhe dytësore. Zyra e Klinikës Ligjore është vendi ku priten qytetarët nga studentët dhe juristë/avokati. Objektivi kryesor i Klinikës Ligjore është ofrimi i një kontributi në formën e ndihmës ligjore falas ndaj grupave të shoqërisë apo individëve, të cilët nuk arrjnë t'i përdorin apo të përfitojnë nga të drejtat dhe lirët të parashikuara me ligj. Klinika Ligjore synon të ndikojë në edukimin e komuniteteve të marxhalizuara në lidhje me të drejtat e tyre duke u shndërruar në mjet për ndryshim shoqëror dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut si edhe edukimin e studentëve në kuadër të avokatisë në interesin publik.

Objektivat e përgjithshme të Klinikës Ligjore: 1. dhënia e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për aktorët e ndryshimit në fushat mjesdit, shëndetësise, të drejtës së konsumatorit etj.; 2. rritja e presionit publik nëpërmjet nxitjes së llogaridhënisë në lidhje me shërbimet e ofruara nga pushteti vendor.

Objektivat specifike të Klinikës Ligjore: të ofrojë shërbime juridike për grupet sociale dhe individët të cilët nuk arrjnë t'i përdorin apo të përfitojnë nga të drejtat dhe lirët e njohura me ligj.

Llojet e shërbimeve juridike që ofrohen: këshillim ligjor, përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën publike, përfaqësimin përrapa organeve administrative, përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën dhe përfaqësimin përrapa gjykatës në çështjet administrative.

Fushat kryesore ku do të ofrohet ndihma: të sigurojë ndihmë ligjore me cilësi të lartë për qytetarët që paraqiten pranë Klinikës; të pasurojë studentët me përvojë praktike ligjore; të aftësojë studentët në hartimin e akteve procedurale administrative/gjyqësore; të ndihmojë studentët të shohin mënyrat dhe mundësitë ku ata të mund të përdorin aftësitë e tyre ligjore për të promovuar drejtësinë dhe interesin publik; t'u ofrojë studentëve mundësinë për të menduar dhe për të praktikuar zgjidhjen e problemeve ligjore.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Rezultatet lidhur me edukimin e studentëve. Gjatë dhe pas pjesëmarrjes në Klinikën Ligjore studentët do të jenë në gjendje: të shpjegojnë se si funksionon ligji në praktikë; të identifikojnë parimet themelore dhe vlerat e çështjeve të ndryshme ligjore; të zhvillojnë aftësi dhe teknika llojore dhe t'i aplikojnë ato; të mësojnë të hartojnë dokumente llojore të saktë dhe gjithëpërfshirëse për qytetarët.

f) Klinika e Fizioterapisë

Klinika e fizioterapisë pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” do të ketë statusin e klinikës universitare dhe të shërbejë për realizimin e procedurave të ndryshme fizioterapike, rehabilituese, mjekësore. Klinika përvèç funksionit didaktik për përgatitjen e studentëve do të shërbejë edhe si njësi shërbimi ndaj të tretëve. Klinika do të jetë e hapur ndaj të gjithë stafit akademik të fakultetit për realizimin e punëve shkencore që janë në përputhje të plotë me legjislatcionin. Klinika do të ofrojë shërbime fizioterapie dhe kërkim shkencor nga profesionistë të fushës së fizioterapisë, të cilët janë të pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit si “fizioterapeut” dhe janë staf akademik apo ndihmës akademik pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Specialistët/personeli akademik dhe ndihmës akademik, do të punojnë në bashkëpunim të ngushtë me njëri-tjetrin në ofrimin e shërbimit, por edhe në realizimin e praktikës mësimore me studentët duke respektuar etikën, hierarkinë dhe komunikimin dinjitoz. Studentët do të zhvillojnë në klinikë praktika mësinore në lëndët mësimore sipas kurrikulës së programit të studimit që ofron programet e studimit Fizioterapi, Infermieri, Mami, Edukim fizik, Kështu studentët do të inkurajohen që të jenë pjesëmarrës sa më shumë të jetë e mundur në çdo aktivitet të klinikës, gjithnjë nën mbikëqyjen dhe kujdesin e personelit akademik. Klinika do t'u shërbejë studentëve për rritjen e tyre profesionale dhe vlerësimin e tyre. Përmes bashkëpunimit me organizata profesionale të fizioterapisë apo klinika të tjera të ngashme, duhet të kriohet mundësia e ofrimit të shërbimit edhe në terren (shtëpi, institucione të ndryshme rezidenciale, spitale private etj.), për pacientët që nuk mund të aksesojnë klinikën. Cdo rast i shërbimit jashtë klinikës/terren pasqyrohet në database të klinikës, direkt pas shërbimit të ofuar.

g) Laboratori Mikrobiologjik

Sot Qendra e Diagnostikimit Mikrobiologjik “Wolfdieter Sixl”. Në zbatim të ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË I NDRYSHUAR. Në maj të vitit 2001 u ngrit laboratori i Mikrobiologjisë së Ujërave në Universitetin e Shkodrës, i cili u financaua nga HRK (Konferenca e Rektorëve Gjermanë) dhe u menaxhua nga pala austriake në kuadrin e projekteve për ligenin e Shkodrës. Laboratori i Mikrobiologjisë së Ujërave sot Qendra e Diagnostikimit Mikrobiologjik “Wolfdieter Sixl” i ka filmit e saj me 1 gusht 2007. Kjo qender prej 15 vjetësh me shërbimin e saj krijon të ardhura shërbim për të tretët për Universitetin dhe njëkohësisht u siguron studentëve të programeve të studimit: *Biologji-Kimi, Infermieri, Mami, Fizioterapi, Master në Biologji-Kimi*, bazën materiale për realizimin e praktikave si një domosdoshmëri për vënien në eficiencë maksimale lëndën e Mikrobiologjisë. Qendra e Diagnostikimit Mikrobiologjik shërbën si laborator reference për të gjithë Qarkun e Shkodrës ku janë realizuar dhe vazhdojnë të realizohen puna kërkimore-shkencore, përgatitja e diplomave, temave të masterave etj. Qendra ka afersisht 15 vjet që është vënë në funksion të qytetit të Shkodrës duke ofruar shërbime për popullatën (për të tretët) përkundrejt çmimave të vendosura nga Senati i Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Laboratori i mikrobiologjisë shërbën për praktiken laboratorike të studentëve të

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Biokimisë, Infermieri-Mamisë dhe Fizioterapië, duke ofruar (shërbime për të tretët) ka rritur të ardhurat e Universitetit. Analizat që ofrohen nga kjo qendër janë si më poshtë: *Ekzaminime për infeksione aerogene (koke), kulturë gryke, hunde, veshi, syri, lëkure ej, Ekzaminime për infeksione intestinale (të zorrëve), koprokulturre (Shigellë, Salmonellë, Escherichia coli). Ekzaminime mykologjike për koprokulturre për candida, kulturë vaginalë për kandida, analiza mykologjike për dermatomykoza etj. Ekzaminime parazitologjike për: A.lumbricoïdes, Enterobius vermicularis, L.intestinalis, T.trichiuris, T.nana, H.diminuta, T.solium, T.staginata. Ekzaminime për ujëra, Analiza për përcaktimin e E.coli në ujë me MPN (me tuba të shumë fermentimi) dhe MF (metoda me filtrim). Kjo qendër realizon funksione mësimore e kërkimore, si pjesë e fakultetit, si dhe funksione diagnostike e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor.*

Objektivi Specifik 4: Integriteti dhe transparencia

Korniza irregullatore e USH-së duhet të promovojoë integritetin akademik, transparencën dhe llogaridhëni si pjesë e standardeve të performancës së sektorit të arsimit të lartë. Nxitja e transparencës dhe e llogaridhëniec ndaj publikut nga ana e USH-së do ta ndihmojë atë të përbushë përgjegjësitë dhe të arrijnë qëllimet, të sigurojnë zbatimin e parimeve dhe standardeve evropiane, si dhe ndërtimin e instrumenteve konkrete e funksionale të monitorimit të performancës së sektorit dhe të USH-së. Në përputhje me nenin 7 të ligjt nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është përgatitur programi i transparencës për Universitetin e Shkodrës. Ky program përcakton kornizën llore të veprimitarisë së autoritetit në kuadër të ligjt nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”(LDI) dhe VKM-në nr. 781, datë 26.12.2018 “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimitarisë së punës së USH-së, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.unishk.edu.al dhe konkretisht ne linkun <https://unishk.edu.al/programi-i-transparencës-2021> si dhe në mëdiset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përbajtje, afat kohor për bëjen publike të tij, mënyrën e bëjës publike, si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Faqja zyrtare e USH-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësish të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikuara, dhënavë personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënavë etj.

Objektivat

- Promovimi i integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhëniec.
- Monitorimi i performances dhe promovimi i integritetit akademik.
- Zbatimi i kodit etik.
- Rritja e peshës së organeve kolegiale.

STRATEGJIA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Më poshtë është paraqitur plani strategjik për përbushjen e objektivave të mësipërme.

- Objektiivi I. Sigurimi i transparencës.					
Aktivitet	Indikatorë/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet	
1.1 Pasqyrimi i detajuar i tij në faqen zyrtare dhe zbatimi i programit të transparencës.	<ul style="list-style-type: none"> > Numri i informacioneve të ofruara në faqen zyrtare dhe cilësia e shërbimit. 	<ul style="list-style-type: none"> > Rektorati > Dekanatet > Departamentet > Drejtoria Juridike dhe Marrëdhënive me publikun 	5 vite akademik e	<ul style="list-style-type: none"> > Kosto kohore dhe financiare e përditësimit të informacionit. 	
Objektiivi II. Monitorimi i performances dhe promovimi i integritetit akademik.					
Aktivitet	Indikatorë/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet	
II.1 Përdorimi i softuerit antiplagjaturë.	<ul style="list-style-type: none"> > Përdorimi i softuerit antiplagjaturë për botimet në buletinet shkencore të USH-së. > Numri i pedagogëve dhe botimeve të përfshira në këtë proces. > Përdorimi i softuerit antiplagjaturë për temat e diplomave. 	<ul style="list-style-type: none"> > Rektorati > Fakultetet > Departamentet 	5 vite akademik e	<ul style="list-style-type: none"> > Kuifizimi i përdorimit të programit edhe për temat e diplomave në të ardhmen. 	
Objektiivi III. Zbatimi i kodeve etike.					
Aktivitet	Indikatorë/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet	
III. 1 Zbatimi i kodit të etikës.	<ul style="list-style-type: none"> > Raporti i shkeljeve të kodit të etikës dhe masave të marrë nga komisioni i etikës. 	<ul style="list-style-type: none"> > Komisioni i etikës USH > Rektorati > Fakultetet > Departamente 	5 vite akademik e	<ul style="list-style-type: none"> > Mund të ketë raste të moszbatimit të kodit të etikës. 	
Objektiivi IV. Ndërtimi i kapacitetit të organeve kolegiale.					
Aktivitet	Indikatorë/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet	

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

IV 1 Rritja e peshës së organeve kolegiale.	> Publikimi në faqen e internetit të USH-së i të gjitha të dhënaave dhe dokumenteve përkatëse. > Numri i dokumenteve që do i nënshkruhen antiplagjaturës të jetë sa më i madh.	> Rektorati Dekanatet Departamentet Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënive me Publikun	5 vite a kademike	> Kosto kohore dhe financiare e përditësimit të informacionit dhe zbatimit të antiplagjaturës.
---	---	--	----------------------	---

Objektivi specifik 5: Studentët

Universiteti i Shkodrës përmes njësive bazë dhe njësive kryesore, gjithashu në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit për Karrierën, bazuar në Statutin dhe rregulloret, krijon një klimë të përshtatshme për kalm më të lehtë të studentëve nga mjedisi i sistemit arsimor të mesëm në mënyrë që do i organizimin e programave të studimit.

Universiteti i Shkodrës realizon informimin e studentëve përmes faqes zyrtare si dhe rjeteve sociale nëpërmjet të cilave informacioni shpërndahet më shpejt tek të rinjtë.

Universiteti i Shkodrës respekton të drejtat e studentëve që u përkasin kategorive të veçanta dhe i mbështet ato gjatë procesit mësimor duke i lehtësuar aksesin në mësimdhënie dhe duke krijuar ambiente të përshtatshme që janë gjithnjë në përmirësim.

Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik (dy studentë) dhe në Bordin e Administrimit, (Statuti i Universitetit, Neni 47,2/b). Ata janë të organizuar në Këshillin Studentor me përfaqësues nga secili fakultet, rezultat i një procesi të rregullt dhe gjithëpërfshirës zgjedhor. Këshilli merr pjesë aktive në çështje që lidhen me të drejtat e studentëve.

Universiteti i Shkodrës ka si pjesë të politikave të tij mbështetjen shumëdimensionale të studentëve. Cdo fakultet ka kontributin e tij në këtë drejtim përmes përfshirjes dhe mbështetjes së studentëve në organizimin kombëtar dhe ndërkombëtar të aktiviteteve/projekteve me karakter shoqëror, kulturor dhe sportiv. Përmes tyre sigurohet një klimë miqësore për shoqërizimin e studentëve edhe jashë auditorëve të universitetit.

Duke u mbështetur në përshtimin e mësipërm mbi securinë që ka USH në arrijen e mbështetjes së plotë të studentëve, objektivat për periudhën 2022-2026 janë si më poshtë.

Objektivat

31



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

- Pasurimi dhe përmirësimi i shërbimeve për studentët.
- Tërheqja e studentëve ekselentë në programet prioritare, siç janë ato të mësuesisë.
- Ndërmjetësimi për punësimin e studentëve.

Më poshtë është paraqitur plani strategjik për përbushjen e objektivave të mësipërme.

Objektivi I. Pasurimi dhe përmirësimi i shërbimeve për studentët.

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat	Përgjegjësia	Koha	Risqet
I.1 Përmirësimi i procesit mbimit këshillimin e karrierës për studentët.	<ul style="list-style-type: none"> > Proses i formalizuar. > Numri i studentëve përfitues. 	<ul style="list-style-type: none"> > Rektorati > Zyra e Këshillimit të karrierës 	Çdo vit	<ul style="list-style-type: none"> > Kosto kohore financiare në realizimin e formalizimit të procesit.
I.2 Shërbime shëndetësore me tarife të reduktuar ose falas për studentët (analiza, trajtim fizioterapie, këshillim psikologjik, konsulencë ligjore) nga vetë shërbimet që ofron USH përpale të treta.	<ul style="list-style-type: none"> > Numri i studentëve përfitues. > Rektorati > Fakultetet > Departamentet > Laboratorët 	Çdo vit	<ul style="list-style-type: none"> > Kosto kohore financiare në mbulimin e këtyre shërbimeve. 	

Objektivi II. Tërheqja e studentëve ekselentë në programet prioritare.

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat	Përgjegjësia	Koha	Risqet
II.1 Promovimi i programeve të studimit që lidhen me mësuesinë.	<ul style="list-style-type: none"> > Numri i studentëve që regjistrohen në programet e mësuesisë. 	<ul style="list-style-type: none"> > Rektorati > Fakultetet > Departamentet > Zyra e Këshillimit dhe Karrierës 	Çdo vit	<ul style="list-style-type: none"> > Mosjetja e fondeve për realizimin e mbëshitetjes financiare.

Objektivi III. Ndërmjetësim për punësimin e studentëve

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
III.1 Organizimi i aktiviteteve me qëllim ndërmjetësimin përpunësimin e studentëve.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i studentëve të punësuar falë ndërmjetësimit të USH-së. ➤ Fakultetet ➤ Zyra e Këshillimit dhe Karrierës 	<ul style="list-style-type: none"> Cdo vit 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mosqjetja e fondeve të miaftueshme përealizimin e aktiviteteve që shërbejnë përdërmjetësim. 	

Objektivi specifik 6: Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë

USH i kushton rëndësi krijimit dhe zhvillimit të një kulture bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përfitimit të ndërsjelltë. Kjo realizohet nëpërmjet krijimit të kushteve më të mira dhe krijimit të mekanizmave e procedurave që nxisin dhe mbështesin aktivitetet e ndërkombëtarizimit. Ne do të fokusohemi në kultivimin e marrëdhënieve të shumëfishta duke eliminuar barrierat dhe duke u nsur nga përfitimi reciprok i paleve të përfshira.

Ndërkombëtarizmi është një investim për të ardhmen dhe kërkon angazhim afatgjatë si nga ana e stafit administrativ dhe akademik të USH-së ashtu edhe nga ana e studentëve dhe e partnerëve.

Arsimi i lartë është një e mirë publike dhe sociale. Për këtë arsy, Universiteti i Shkodrës, ndjen përgjegjësinë për të gjeneruar dhe ndarë dijet, njojuritë për më të mirën e shoqërisë. Gjithashu, ai është i ndjeshëm edhe ndaj ngjarjeve dhe zhvillimeve rajonale. Ne jemi të angazhuar të zhvillojmë kapacitetet jo vetëm në vendin tonë, i cili konsiderohet si një vend në zhvillim, por edhe në rajon (BALLKAN) duke ndikuar kështu në një qëndrueshmëri më të lartë. Njëkohësisht ne jemi të anagazhuar të zhvillojmë bashkëpunime edhe me Universitete apo institutë kërkimore në vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjërë.

USH ka si qëllim të mbajë standarde të larta në të gjitha aktivitetet që ndërmerr, si në fushën e mësimdhënies, të kërkimit shkencor ashtu edhe në bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për zhvillimin e projekteve të ndryshme.

Universiteti i Shkodrës ka si qëllim të përqendrojë përpjekjet dhe burimet e tij edhe në bashkëpunimet me vendet e rajonit, përvetës bashkëpunimit me vendet evropiane dhe në nivel kombëtar.

STRATEGJIA E ZHILLIMITËS UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Studentët janë një forcë shumë e madhe shtytëse e ndërkombëtarizimit. Ne synojmë që nismat dhe programet ndërkombëtare të marrin në konsideratë në mënyrë sistematike nevojat, prishmëritë dhe eksperiençat e studentëve. Ne besojmë se studentët duhen fuqizuar që të aktivizohen dhe menaxhojnë vëtë aktivitete ndërkombëtare. Projektit dhe organizatat studentore do të jenë krahу ynë i djathtë dhe do të mbështeten, asistohen dhe trajnohen për t'i angazhuar në aktivitete ndërkombëtare.

USH i kushton rëndësi vëniies në dispozicionit të gjithë informacionit të vlefshëm për stafin dhe studentët për t'u njojur me mundësitë e bashkëpunimit dhe mobilitetit e dyanshme, si dhe zbatim transparent të procedurave përkatëse.

USH i kushton rëndësi krijimit dhe ruajtjes së lidhjeve afatgjata me ish-studentë (alumni) dhe ish-anëtarë të stafit akademik që punojnë në universitetë të huaja, institute këkkimore ose organizata të tjera. Përfshirja e kapaciteteve intelektuale të diasporës shqiptare dhe alumni kontribuon në shtimin e potencialeve në USH në fusha të ndryshme duke rritur kështu nivelin e shkëmbimit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar. Duke u mbështetur në përshtkrimin e mësipërm mbi sfidën që ka USH në fushën e ndërkombëtarizimit, në vijim po parashtrojmë objektivat për periudhën 2022-2026.

Objektivat

- Rritja e numrit të projekteve ndërkombëtare.
- Rritja e numrit të mobiliteteve të dyanshme të stafit dhe studentëve.
- Zgjerimi i rjetit të institucioneve partnerë.

Më poshtë është paraqitur plani strategjik për përbushjen e objektivave të mësipërme.

- *Objektivi I.* Rritja e numrit të projekteve ndërkombëtare.

Aktivitetet	Indikatorët/Vlerat	Përgjegjësia	Koha	Risqet
Target				

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

<p>I.1 Realizimi i një studimi lidhur me bashkëpunimin në fushën kërkimore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Studim lidhur me bashkëpunimin e çdo pedagogu, departamenti, fakulteti me institucionet e huaja. 	<p>Fakultetet DMZHJ Rektori Departamentet Administratori</p>	<p>1 vit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare në realizimin e studimit.
<p>I.2 Përfshijje e ekspertëve dhe profesionistëve që kanë eksperience në përpilimin e projekteve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i ekspertëve të përfshire. ➤ Afimi i tyre pranë zyrës së Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me jashtë përritjen e cilësisë së projekteve. 	<p>Rektori Departamentet Administratori</p>	<p>Çdo vit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare në realizimin e rekrutimit të ekspertëve me honorare.
<p>I.3 Zhvillim i mekanizmave dhe mjeteve për mbështetje financiare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Krijimi i një "Fondi për mbështetjen e projekteve", i cili do të monitorojë fazat përgatitore dhe fillostarte të projekteve. 	<p>Fakultetet Rektori Administratori</p>	<p>Çdo vit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vështirësi për mbështetje ligjore.

Objektivi II. Kritja e numrit të mobiliteteve të dyanshme të stafit dhe studentave.

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
II.1 Rritja e numrit të mobiliteteve në programet ndërkombëtare për pedagogët dhe studentët.	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Numri i pedagogëve dhe studentëve (gjithëpërfshirja). 	<p>Fakultetet Rektorati Bordi i Administrimit</p>	<p>Një herë në vit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kosto kohore dhe financiare.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

II.2 Ofrimi i sa më shumë programeve mësimore në gjuhë të huaj (me prioritet gjuhën angleze).	► Numri i programeve studimore në gjuhë të huaj	Fakultetet Rektori Administratori	Çdo vit	► Kosto kohore dhe financiare në hapjen e programeve të reja ► Interes i ulët nga studentët e huaj.
II.3 Rritje e fondeve për financimin e kërkimit shkencor për stafin akademik	► Sasia e fondeve të shpenzura për kërkimin shkencor.	Fakultetet Senati akademik Rektori Bordi i administrimit Administratori	► Kosto financiare e pamjaftueshme për të mbuluar nevojat e gjithë stafit.	
<i>Objektivi III. Zgjerimi i rrjetit të institucioneve partnerë.</i>				
Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
III. 1 Shtimi i partneriteteve me universitetet, organizatat kërkimore dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë, sidomos me ato të rajonit.	► Nënshkrimi i marrëveshjeve.	Rektori Fakultetet DZHMI+Dekanet Departamentet	Çdo vit	► Ulje interesimit të partnerëve për të nënshkuar ose rinovuar marrëveshje bashkëpunimi.
III.2 Rritja e numrit të konferencave dhe seminareve ndërkombëtare të zhvilluara në USH.	► Numri i konferencave dhe seminareve ndërkombëtare të zhvilluara në USH.	Fakultetet Departamentet	Çdo vit	► Kosto financiare dhe kohore në kryerjen e organizimeve të tilla.
III. 3 Ndërkombëtarizimi i Buletinit Shkencor të -së.	► Përfshirja në redaksinë e buletinit të kërkuesve të huaj. ► Përkthimi i buletinit në gjuhë angleze.	Rektori Fakultetet Redaksitë	Çdo vit	► Kosto financiare dhe kohore në kryerjen e këtij procesi.

SHKODER

UNIVERSITY

BULETIN SHKENCOR

PËRKTHIMI I BULETINIT SHKENCOR

GJUHË ANGLEZE

987453210

STRATEGJIA E ZHILLIMITËS UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

	► Përfshirja e produktit të kërkimit shkencor të studentëve të nivelit Master shkencor.
--	---

Objektivi specifik 7: Shërbimet digitale

Shfrytëzimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka ndikuar dukshëm në avancimin e arsimit të lartë, si nga aspekti i përbajtjes së programeve studimore, ashtu edhe i mënyrës së studimit.

USH ka adoptuar sistemin e menaxhimit të studentëve “ESSE3” më pas Pitagora që nga viti akademik 2013, i cili kryen funksionin në formë elektronike, krahas asaj të shkruar. Para këtij viti disponohet një regjistr i tillë vetëm në formë të shkruar. Platforma Pitagora për menaxhimin e studentëve, garanton një menaxhim efikas të të dhënavë të studentit gjatë gjithë karierës së tij dhe pas saj.

Universiteti i Shkodrës disponon laboratorë të IT-së, Sektorin e Menaxhimit të Sistemit, serverat, telefoninë. USH publikon në faqen zyrtare të gjitha të dhënat statistikore për numrin e studentëve sipas programeve, ofertën akademike, ndërtimin dhe funksionimin e institucionit, si dhe statutin dhe rregulloret e funksionimit të tij. (www.unishk.edu.al).

Në USH përdoret nga i gjithë stafi akademik aplikacioni SMAK si një software për menaxhimin akademik, i ndërtuar si rezultat i domosdoshëm për informatizimin e menaxhimit akademik. Softi është i bazzuar në teknologjinë web dhe si i tillë është i aksesueshëm nga çdo kompjuter i lidhur në internet. Të dhënat janë të ruajtura në një bazë të dhëash qendrore në një server, i cili ndodhet në ambientet e AKSHI-t.

Universiteti i Shkodrës punon për informatizimin në çdo hap të punës student - sekretari mësimore- staf akademik. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë në USH, bashkërendon vepritaritë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar përmes tyrejtës së datave, datat e provimeve, strukturën organizative, organigramën, detyrimet e studentit, tarifat e studimit, vlerësimet e studentëve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së. (www.unishk.edu.al).

STRATEGJIA E ZHVILLIMITTE UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Kështu, falë TIK-ut, studentët sot kanë akses në materiale mësimore cilësore. Ndërsa përsë u përket programeve të studimit në distancë dhe ato të kombinuara të cilët ofrojnë mundësi për fleksibilitet maksimal sa i përket impenjimeve kohore, mbeten akoma të parashtrojmë objektivat për periudhën 2022-2026.

Objektivat

- Përmirësimi i infrastrukturës së TIK-ut në IAL dhe i vizibilitetit në web.
- Organizimi i mësimit në distancë dhe të nxënës e kombinuar.
- Ofrimi i shërbimeve digitale cilësore për studentë.

Më poshtë është paraqitur plani strategjik për përbushjen e objektivave të mësipërme.

- *Objektivi I. Përmirësimi i infrastrukturës së TIK-ut në USH dhe i vizibilitetit në ueb.*

Aktivitet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
I.1 Investime në përmirësimin e infrastrukturës së TIK-ut në USH.	► Numri i investimeve të kryera. ► Rektorati ► Bordi i Administrimit ► Administratori	► Fakultetet ► Kosto kohore dhe financiare në realizimin e investimeve.	1 vit	

SHKO
TIK-ut në USH

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

I.2 Hartimi i politikave për zhvillimin dhe mirëmbajjen e faqes të internetit.	<p><i>Objektivi II.</i> Organizimi i mësimit në distancë dhe të nxënës në kombinuar.</p>			
	Rektori Fakultetet Drejtoria e IT	Çdo vit	Administratori	► Kosto kohore dhe financiare në realizimin e politikave të IT-ve.
Aktivitetet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
II.1 Sigurimi i aksesit në platformat digitale për USH-në.	► Numri i kurseve në distancë dhe të nxënës e kombinuar sipas fushave.	Rektori Fakultetet Bordi Administrativ	Një herë në vit	<ul style="list-style-type: none"> ► Kosto kohore dhe financiare në hapjen e programeve të reja. ► Mospasje interesimit nga studentët e huaj.
II.2 Trajinim i stafit akademik për shfrytëzimin e platformave digitale.	<ul style="list-style-type: none"> ► Numri i trajimeve të realizuara. ► Numri i stafit të trajnuar. 	Fakultetet Rektori Administratori	Çdo vit	<ul style="list-style-type: none"> ► Kosto kohore dhe financiare për realizimin e procesit të trajimeve.
<i>Objektivi III.</i> Ofrimi i shërbimeve dixhitale cilësore për studentë				
Aktivitetet	Indikatorët/Vlerat Target	Përgjegjësia	Koha	Risqet
III. 1 Sigurimi i aksesit në biblioteka digitale. Bashkëpunimi me organizma të ndryshëm për të siguruar akses në bibliotekat digitale.	<ul style="list-style-type: none"> ► Kënaqësia e studentëve me shërbimet digitale. 	Dekanët Fakultetet Rektorati	Çdo vit	<ul style="list-style-type: none"> ► Mospasje interesimi nga partnerët për të nënshtkuar marrëveshje bashkëpunimi.
		Fakultetet		

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026



<p>III.2 Mbështetje për studentët për blerjen e pajisjeve personale.</p>	<p>► Numri i studentëve që marin mbështetje.</p>	<p>Rektori Fakultetet Administratori</p>	<p>Në 5 vite</p>	<p>► Mosgjetje e fondeve te nevojshme.</p>
--	--	--	------------------	--

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Analiza SWOT



STRATEGJA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Anët e fortë:

- Lal me një eksperiencë 65 - vjeçare.
- Stafi i kualifikuar.
- Aplikimi i modeleve të reja të mësimdhënies, përgjegjshmërisë në realizimin e procesit mësimor.
- Koordinim dhe lidhje e fakulteteve nëpërmjet programeve të përbashkëta të studimit.
- Raporte të mira midis stafit akademik dhe studentëve.
- Lidhje të ngushta me tregun e punës, bashkëpunime të mira mes bizneseve të rajonit, institucioneve qendrore dhe vendore.
- Aktivitet i konsoliduar shkençor i stafit akademik (botime dhe pjesëmarrje apo organizime në konferanca ndërkombëtare).
- Ofrimi i programeve të larmishme të studimit në përputhje me nevojat dhe kërkosat e tregut.
- Krijim dhe konsolidim i rrjeteve të bashkëpunimit në projekte të ndryshme me universitetet e rajonit dhe ato përendimore.

Anët e dobëta

- Fonde të pamjaftueshme të gjeneruara nga veta USH përzgjedhmin e infrastrukturës së USH-së.
- Mungesa e autonomisë financiare në nivel fakulteti dhe departamenti.
- Mjetet didaktike dhe laboratorike të kufizuara në raport me zhvillimin teknologjik dhe numrin në rrije të studentëve në disa programe studimi
- Mungesa e autonomisë financiare në nivel fakulteti dhe departamenti.

Mundësítë:

- Mundësi të shuma mobilitetesh për stafin dhe studentët në universitetet përendimore, në kuadrin e projekteve të ndryshme të bashkëpunimit.
- Cela e programeve të studimit në bashkëpunim me universitetet përendimore.
- Përfshirja e universitetit në programet CEPUS dhe Erasmus +
- Rritja e interesit pë të studiar pranë USH-së e studentëve nga rajoni, vegenërisht nga Ulqini dhe Kosova.

Kërcënimet:

- Ndryshimet ligjore dhe ato të tregut të punës të cilat ndryshojnë edhe kërkosat për profesione e specialistë të caktuar.
- Konkurenca me universitetet e tjera.
- Largimi i mundshëm i stafit të kualifikuar drejt universiteteve të huaja.

SHK
UNIV.

STRATEGJA E ZHILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJ GURAKUQI” 2022-2026

Përbledhje e akronimeve

- USH** - Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- OJF** - Organizata Jofitimprurëse.
- TIK** - Teknologja e Informacionit dhe Komunikimit.
- FGJH** - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.
- FSHN** - Fakulteti i Shkencave të Nayrës.
- FSHSH** - Fakulteti i Shkencave Shoqërore.
- FSHE** - Fakulteti i Shkencave të Edukimit.
- FE** - Fakulteti Ekonomik.
- IAL** - Institucion i Arsimit të Lartë.
- LMS** - Sistemi i Menaxhimit të Studimit.
- ILP** - Instituti i Lartë Pedagogik i Shkodrës.
- BE**- Bashkimi Evropian.



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI” 2022-2026

Referenca

- STRATEGJIA KOMBËTARE E ARSIMIT 2021-2026⁴
- MASR, "Liqj Nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënlidgore në zbatim të tij," MASR, 31.10.2019.
- Statuti i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
- Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë 2021⁵
- Bartlett, William. (2017). From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in the Western Balkans.
- Cleary, J.L., & Noy, M.V. (2014). A Framework for Higher Education Labor Market Alignment: Lessons and Future Directions in the Development of Jobs--Driven Strategies. Working Paper.
- <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/#tab2>
- OECD (2017), In-Depth Analysis of the Labour Market Relevance and Outcomes of Higher Education Systems: Analytical Framework and Country Practices Report, Enhancing Higher Education System Performance, OECD, Paris
- Strategjia e tregut të punës e USH-së, 2017-2021.
- Strategjia e Ndërkombëtarizimit e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" 2022-2026

⁴ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>

⁵ <https://www.ascal.al/media/documents/legislacioni/VKM%20Nr.824,%20dat%C3%AB%2024.12.2021%20P%C3%AB%20miratimin%20e%20Kodi%20%20C3%AB%20Cii%C3%AB%C3%ABs%C3%AB%20s%C3%AB%20Arsimit%20t%C3%AB%20Lart%C3%AB%20Kodi.pdf>

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIJGJ GURAKUQI” 2022-2026

Grupi i punës:

1. Prof. As. Dr. Paulina Hoti - Kryetar
2. Prof. As. Dr. Ermira Kalaj - Anëtar
3. Prof. As. Dr. Albana Begani - Anëtar
4. Prof. Dr. Anila Neziri - Anëtar
5. Prof. As. Dr. Nevila Dibra - Anëtar
6. Prof. As. Dr. Zamira Shabani - Anëtar
7. Dr. Alva Dani - Anëtar
8. Dr. Jonida Lesha - Anëtar
9. Dr. Vilka Rupa (Lulaj) - Anëtar

Adresa: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Sheshi 2 Prilli, Shkodër, Albania

Tel:+ 355 (22) 800 651

E-mail: info@unishk.edu.al

www.unishk.edu.al

